

VENDIM
Nr.408, datë 22.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.236, DATË 6.3.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E QENDRËS NDËRUNIVERSITARE TË ZHVILLIMIT
TË TELEMATIKËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9704, datë 2.4.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet”, dhe të nenit 6 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kudo në vendimin nr.236, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave, emërtesa “Qendra Ndëruniversitare e Zhvillimit të Telematikës” zëvendësohet me “Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe e Rrjetit Telematik”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha